LIGJ
Nr. 47/2015

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9235, DATË 29.7.2004, "PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 24

Afati për procesin e njohjes, të kthimit e të kompensimit të pronave të paluajtshme dhe afati për kryerjen e procesit të pagesës së kompensimit, të përcaktuar në nenin 23, të këtij ligji, është data 30.10.2015.".

Neni 2

Në nenin 28, data "30.4.2015" zëvendësohet me datën "30.10.2015".

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.5.2015

Shpallur me dekretin nr. 9107, datë 21.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani